

**Arbana QERIQI-GASHI**

**ZËRI I LUFTËTARES SË LIRISË, VEPRIMTARES DHE  
PUBLICISTES, FETNETE RAMOSAJ**

Jeta dhe veprat e Fetnete Ramosajt pa dyshim se zënë vend meritore në mesin e grave luftëtare e intelektuale, ndër më të njohurat jo vetëm në Kosovë, por edhe në trojet tona e më gjerë. Është histori e veçantë e një gruaje, e cila qysh në rininë e hershme e kishte kuptuar se jeta nuk është vetëm sa për ta jetuar e për ta gëzuar, por është edhe angazhim punë, aktivitet, detyrë e përgjegjësi, qofshin ato familjare, shoqërore, kombëtare por edhe humane.

E lindur dhe e rritur në një familje bujare, e edukuar kombëtarisht e njerëzisht, e pajisur me pajën më të bukur të intelektit e të mbrothësisë, Fetnetja kishte çarë rrugën e saj jetësore duke u armatosur me dije dhe me virtytet më të mira e më të shtrenjta të traditës kombëtare. Në moshën e saj të pjekurisë ajo inkadrohet në radhët e rinisë revolucionare të Kosovës, jo vetëm si një studente e zellshme, por në radhë të parë si një aktiviste kombëtare, e cila me kohë e kishte kuptuar se atdheu padrejtësisht vuante nën robërinë serbe, e kishte kuptuar se Kosova si pjesë e tërësisë etnike të Shqipërisë, iu kishte shkëputur trugut, dhunshëm e padrejtësisht, e kishte kuptuar se ajo e meritonte lirinë, drejtësinë e barazinë. Por, liria nuk vinte me lindjen e përditshme të diellit, as me pranverën kur natyra gjallërohet. Me kohë e kishte kuptuar se liria nuk vinte vetvetiu, por duhej punë, angazhim, bashkim mendjesh, idesh e forcash, në mënyrë që ajo të fitohej, me çdo kusht, me çdo sakrificë e me çdo çmim. Në rrugën e lirisë ajo kishte takuar bashkëmendimtarë e bashkëveprimtarë, me të cilët ishte nisur në rrugën e madhe, në rrugën e rrezikshme, me mund e sakrifica, duke i besuar fort fitores dhe duke

u bërë pjesë e pandashme e saj, ashtu sikur kanë bërë gratë shqiptare gjatë tërë historisë. Fetnete Maxhun Ramosaj, ka lindur më 12 shtator 1972, në fshatin Carrabreg i Poshtëm, komuna e Deçanit. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në vendlindje. Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë, fakultetin dhe studimet pasuniversitare, në Prishtinë. Ka magjistruar në shkencat e sigurisë. Që nga viti 1989, si nxënëse e shkollës së mesme ishte pjesëtare aktive e lëvizjes ilegale dhe asaj gjithëpopullore në Kosovë. Ishte udhëheqëse e Grupit Revolucionar për Bashkimin e Trojeve Shqiptare (1992), pjesëmarrëse në demonstrata, anëtare e kryesisë së Forumit Rinor, Dega në Deçan, nismëtare dhe bashkëthemeluese e revistës “Zgjimi”- Deçan (1991-1997), ishte nënkryetare e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (në Nënkëshillin në Deçan), nënkryetare në Partinë e UNIKOMB-it, Dega në Deçan, ku pas shuarjes së kësaj partie ishte sekretare në Partinë Parlamentare të Kosovës (PPK), Dega në Deçan.

Fetnetja krahas aktivitetit legal ka zhvilluar edhe aktivitet ilegal deri në fillimin e luftës së UÇK-së. Gjatë këtyre viteve në Deçan por edhe në tërë rajonin e Dukagjinit e më gjerë, Fetnetja ishte e pranishme pothuajse në të gjitha aktivitetet politiko-shoqërore. Gjatë luftës, ka qenë eprorë e lartë. Ka qenë përgjegjëse për Informim Publik dhe zëdhënëse e UÇK-së për Zonën Operative të Dukagjinit. Gjatë kësaj kohe ka raportuar nga fronti i luftës për Radion “Kosova e Lirë”, Agjencinë e Lajmeve të Kosovës “Kosovapress”, Radio Televizionin Shqiptar etj. Gjatë luftës ka bashkëpunuar me agjencitë e lajmeve “Deutsche welle”, “BBC”, “Zëri i Amerikës” dhe me shtypin shqiptar të kohës në Kosovë, Shqipëri, në mërgatë etj. Pas përfundimit të luftës ka qenë shefe e Sektorit të Informimit Publik të Zonës së Tretë të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës, gradën e koloneles, deri në fund të vitit 2001 ku ishte demobilizuar me vetë dëshirë nga radhët e TMK-së. Prej vitit 2010, ka qenë bashkëthemeluese dhe drejtoreshë për hulumtime shkencore në Institutin për Studime Gjeopolitike dhe Siguri (ISGJS) me seli në Prishtinë. Ka punuar në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë. Në Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës ka punuar nga viti 2013 deri në gusht të vitit 2018. Fetnetja është autore e qindra biografive për dëshmorët e kombit që janë botuar në edicionin “Feniksët e lirisë”, ku ishte bashkëpunëtare derisa ndërroi jetë. Është autore e disa fejtoneve e dhjetëra shkrimeve publicistike, të botuara në shtypin legal e ilegal të kohës që nga viti 1991, pastaj recensuese, lektore dhe redaktore e disa librave publicistikë, historikë

e të çështjeve të sigurisë; pjesëmarrëse me kumtesa shkencore në disa simpoziume e konferenca shkencore ndërkombëtare, ekspozita etj.

### **Fetnete Ramosaj, personalitet i kompletuar në të gjitha segmentet intelektuale, shoqërore e kombëtare**

Ftete Ramosaj jetoi 20 vjet pa një punë meritore, më meritorja e kohës së luftës dhe e paqes. Po aq vjet përballje me të gjitha sfidat, pa një ndihmë meritore nga shteti, të cilit i dha tërë jetën e saj nga rinia e hershme e deri në fund, kur gjysmën tjetër të jetës ia mori para kohe vdekja e tmerrshme. Ishte shumë e vullshme dhe e papërmbajtur kundër dhunës e barbarisë serbe. Ishte e pranishme kudo ku flitej për atë dhunë e barbari, në takime e simpoziume, ashtu sikur edhe kishte raportuar nga frontet e luftës në Dukagjin, gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pjesëtare e së cilës ishte qysh në radhët e para. Fetnetja kudo ku ishte, shfaqej e gatshme për të treguar njerëzi, kulturë, dinjitet e temperament të një gruaje shqiptare, e cila eci krah hapur me trimat e trimëreshat e Kosovës në rrugën e saj për çlirimin e atdheut, të përparimit dhe bashkimit të kombit.

Ajo ishte kudo në vendet ku flitej e dëshmohej e vërteta për Kosovën: në Deçan, në Pejë, në Prishtinë, në Shkup, në Shkodër, në Tiranë e kudo në trojet tona. Ajo nuk i duronte maskat, ajo i çirrte ato, andaj sado që u anashkalua nuk mbeti në margjina, sepse puna e saj e pandërprerë, e ndershme, e përkushtuar shkencore e profesionale kishte çarë me dinjitet rrugën drejt emancipimit dhe perceptimit tejet realist të problemeve, të cilat i ka trajtuar në studimet e saj. Fetnetja me jetën, punën, veprën e saj radhitet në mesin e grave shqiptare që kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, për çlirimin e vendit, për emancipimin shpirtëror të shqiptarit e të shqiptares të kohës sonë, për studimet shkencore në zbardhjen e krimeve dhe të gjenocidit shekullor serb mbi shqiptarët dhe tema të shumta që i ka trajtuar gjatë tërë jetës së saj të shkurtër, por të pasur, të begatë e shumë të dinjitetshme. Fetnetja me zërin e saj sa të qetë e të dashur, nuk është më fizikisht në mesin tonë, por ka qenë, është, dhe do të mbetet kurdoherë në kujtesën tonë, me sjelljen dhe veprat e saj, me intelektin e botën e pasur me dije, kulturë e emancipim. Ajo na i ka lënë veprat dëshmi të jetës, punës, aktivitetit, të një jete të tërë në shërbim të kombit e atdheut. Për jetë e mot do të kujtohet në mesin e grave më të njohura të historisë sonë më të re. Dhe ne, Fetnete, jemi krenarë që të

patëm, krenare për kohën, luftën e pasluftën që kaluam bashkë, për amanetin që na ke dhënë, për të mos e ndalur luftën, sepse po u ndal lufta, vdes jeta.

Mjafton ta lexoni këtë fjali të shkruar nga Fetnete Ramosaj dhe të kuptoni personalitetin e saj: “Jam shumë e nderuar dhe krenare që isha pjesë e luftës për liri, e njerëzve të terrenit, që mbi gjithçka e kishim lirinë! Ashtu janë dhe duhet të jenë të gjithë bashkëluftëtarët e mi, pavarësisht sfidave të kohës! Jo gjithkush e ka fatin të jetë pjesë e bërjes së lirisë!”, - shkruante mes tjerash Fetnetja, motra jonë e paharruar. Andaj, askush më shumë se Fetnete Maxhun Ramosaj nuk e plotësoi rolin e grave në jetësimin e shtetësisë së Kosovës në të gjitha segmentet. Fetnetja me punën, aktivitetin, angazhimin e saj jetësor u bë pjesë e grave të mirënjohura ilire, arbërore, shqiptare që kanë lënë gjurmë në historinë e kombit.

Fetnete Ramosaj është autore e këtyre librave:

-Deçani (Monografi), në bashkautorësi me Faton Mehmetaj, botoi “Zgjidhimi”, Deçan, nëntor 1997.

-Krimet serbe në Kosovë - PA APOLOGJI - “Me fakte kundër shpifjeve” / “Serbian crimes in Kosova - WITHOUT APOLOGY - Facts Against Defamations” (Vëllimi i parë, shqip/anglisht), botoi “Fokusi”, Prishtinë, 2005.

-Krimet serbe në Kosovë - PA APOLOGJI - “Me fakte kundër shpifjeve”, (Vëllimi i dytë), botoi “Anatema”, Prishtinë, 2008.

Serbian crimes in Kosova - “Without Apology - Facts Against Defamations”, (The Second Volume), botoi “Anatema”, Prishtinë, 2008.

-“Organizatat ekstremiste serbe në Kosovë”, botoi ISGJS, Prishtinë, 2013, (i ribotuar me plotësime në vitin 2015); “Serbian extremist organizations in Kosova”, ISGJS, Prishtinë 2015. Ky libër është përkthyer edhe në gjuhën bullgare nga albanologu dhe politikologu i njohur bullgar Anton Pançev.

-Libri: “СРЪБСКИТЕ ЕКСТРЕМИСТКИ ОРГАНИЗАЦИИ В КОСОВО” është botim i përbashkët i Institutit për Studime Gjeopolitike dhe Siguri në Prishtinë dhe Balkanski Nauçen Institut të Sofjes, 2017;

-Kundër Harresës - Gjenocidi i Serbisë në Kosovë 1998-1999/ AGAINST FORGETFULNESS - Serbian Genocide in Kosova 1998-1999”, IHKL, Prishtinë, 2017 etj.

Fetnete Ramosaj, realizoi ekspozita për luftën në Kosovë, ndër të cilat veçohet ekspozita “Terrori dhe gjenocidi i Serbisë në Kosovë 1998-1999”, IHKL, Prishtinë, 2015, e cila u hap në Prishtinë në vitin 2015, në Tiranë e në Korçë në vitin 2016.

Fetnete Ramosaj ishte denoncuesja më e zëshme e gjenocidit që kryen forcat serbe në Kosovë, deri më 5 prill 2019, kur pushoi së rrahuri zemra e saj. Fetnetja, për vepra jetësore u nderua me mirënjohje dhe çmime të ndryshme. Pas vdekjes është dekoruar me mirënjohje e dekorata, i janë botuar libra të lëna në dorëshkrim por jo të gjitha. Ne na mbetet obligim që të botojmë të gjitha dorëshkrimet e Fetnetes, sepse janë vlerë e pasuri për kombin, shtetin tonë por edhe më gjerë.

### **Shtojcë:**

### **Disa nga raportet tonike të reporteressë së luftës, Fetnete Ramosajt, zëdhënëse pranë Komandës së Zonës Operative të Dukagjinit**

#### **1 qershor 1999, Fetnete Ramosaj - Sektori për Informim nga Zona Operative e Dukagjinit**

“Sot në rajonin e Zonës Operative të Dukagjinit që prej orës 04:30 të mëngjesit po zhvillohen luftime të rrepta mes forcave okupuese serbe dhe njësisive të rregullta të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Luftime më të rrepta janë duke u zhvilluar në vijën frontale Pozhar, Lumbardhë, Dashinoc, Vranoc deri në Buqan, ku forcat serbe kanë sulmuar me një numër të madh forcash këmbësorie, 12 tanke, 4 praga dhe mjete tjera të blinduara. Pozicionet e UÇK-së, vazhdimisht po granatohen me artileri të rëndë, nga tanket e minahedhësit e kalibrave të ndryshëm, 62 mm, 82 mm dhe 122 mm, nga prapavija e armikut si nga Pozhari, Lluka e Poshtme, Kodrat e Kotradiqit dhe Barani. Njësitë e rregullta të UÇK-së me sakrificë e qëndresë të pashembullt po i bëjnë ballë me sukses kësaj ofensive të forcave ushtarake policore e paramilitare serbe, duke i mbrojtur me çdo kusht pozicionet e veta. Deri në këto momente në radhët e UÇK-së nuk ka humbje në njerëz, ndërsa nga radhët e armikut janë vrarë tre policë serbë dhe në fshatin Lumbardhë është shkatërruar një autobлиндë e policisë serbe”.

#### **4 qershor 1999, raporti tonik nga Fetnete Ramosaj**

“Gjatë tërë kohës së zhvillimit të luftimeve forcat serbe po bëjnë presion të vazhdueshëm duke granatuar me artileri të rëndë nga një vijë mjaft e gjerë harkore, duke filluar nga Shaptej, Irzniqi, Pozhari, Lumbardhi, Broliqi e deri tek kodrat e Kotradiqit. Në orët e paradites forcat ushtarake policore e paramilitare serbe, tentuan të depërtojnë në pozicionet e UÇK-së edhe nga drejtimi i Gërgocit, por edhe kjo tentativë u pengua nga luftëtarët e Brigadës 132 “Myrtë Zeneli”. Gjatë luftimeve të zhvilluara në Gërgoc ra heroikisht luftëtari Selim Salihu nga Gërgoci. Luftëtarëve të UÇK-së, të rajonit të zonës Operative të Dukagjinit, një ndihmesë e veçantë dje dhe sot iu dha nga forcat ajrore të NATO-s, të cilat kryen një varg sulmesh ajrore mbi pozicionet dhe bazat e artilerisë së rëndë dhe mjeteve të blinduara serbe si në fabrikën e pompave me piston dhe në fabrikën e mobileve “Shipad” në Deçan, ku ishin të stacionuara një numër i konsiderueshëm i tankeve, topave, minahedhësve, kamionëve ushtarakë dhe mjeteve tjera ushtarake. Po ashtu janë goditur edhe pozicionet serbe në Sukë të Vogël, në Gërgoc, në Kralan, në Shaptej, në Gllogjan, në Llukë të Poshtme, në Smolicë, në Shkollë të Botushës, Jasiq e të tjerë, ku u janë shkaktuar dëme të mëdha forcave serbe”.

#### **9 qershor 1999, zhvillimet e 24 orëve të fundit në Dukagjin nga reporterja e luftës Fetnete Ramosaj**

“Edhe pse gjatë orëve të mesditës së ditës së djeshme intensiteti i luftimeve ishte më i ulët në krahasim me ditët e mëparshme, sërish forcat serbe i sulmuan pozicionet e UÇK-së, në Ratishë të Epërme e në Dashinoc, por hasën në rezistencë të fuqishme të njësisve të UÇK-së, të cilat i zmbropsen me sukses. Mbrëmë në mes të një aksioni të kryer mes fshatrave Lumbardhë e Dashinoc njësitë e Togës së Parë, të Kompanisë së Tretë të Batalionit të Parë të Brigadës 132 “Myrtë Zeneli”, zunë një kamion të forcave serbe me një sasi të konsiderueshme municioni, pajisje të ndryshme ushtarake, mjete sanitare, dhe vranë tre policë serbë. Gjatë ditës së sotme në ZOP të Dukagjinit po zhvillohen luftime sporadike përgjatë vijave të frontit”.

## 10 qershor 1999

“Edhe përkundër arritjes së marrëveshjes për tërheqjen e forcave serbe nga Kosova, edhe gjatë ditës së sotme forcat serbe po vazhdojnë me provokime ndaj pozicioneve të UÇK-së. Kështu gjatë paradites në drejtim të pozicioneve të UÇK-së, në drejtim të Ratishit të Epërm, Pozharit e Dashinocit ka granatime sporadike. Në shumë rajone të ZOP të Dukagjinit si në Smolicë, Ramoc, e vende të tjera të Rekës së Keqe, forcat serbe janë duke djegur masovikisht shtëpitë e shqiptarëve. Ato në shumë rajone kanë bërë edhe minimin e terrenit dhe rrugëve kryesore dhe rrugicave të fshatrave ku ishin të stacionuara, si në: Broliq, Kodradiq, Lumbardhë, Pozhar etj. Dje rreth orës 17:30 minuta një njësit i UÇK-së, i ndihmuar edhe nga Njësia Speciale dhe Togu i Batalionit të Parë të Brigadës 133 “Adrian Krasniqi” në lagjen e Elshanëve në fshatin Ozdrim likuidojnë katër policë të uniformuar serbë, të cilët kishin hyrë për të djegur dhe plaçkitur shtëpitë e kësaj lagjeje. Ky aksion u ndërmor në shenjë hakmarrjeje të rënies së eprorit të Njesisë Speciale, Menhend Dervishaj, i cili para disa ditësh ra heroikisht në këtë vend. Njësit i u kthye pa humbje”.

## 25 maj 1999

“Dje gjatë tërë ditës në ZOP të Dukagjinit u zhvilluan luftime tejet të rrepta. Njësitë e Brigadës 131 “Jusuf Gërvalla” kanë marrë një sulm të furishëm kundër forcave serbe të pozicionuar një ditë më parë në Lumbardhë, të cilët i detyruan të lëvizin nga këto pozicione duke lënë të vrarë 7 policë serbë, kufomat ë të cilëve nuk kanë arritur t’i tërheqin nga vendi i ngjarjes. Me këtë rast njësit i UÇK-së, ua mori forcave armike 20 automatikë, 30 bomba, një pushkë mitrolez dhe armatim tjetër. Luftimet më të ashpra u zhvilluan në vijën e frontit Vranoc, Buqan, Llugagji. Në këtë vijë njësitet e Brigadës 135 “Agim Zeneli” gjatë tërë ditës luftuan kundër forcave ushtarako-policore serbe. Ata përdorën 10 tanke 3 praga, 25 mjete tjera të blinduara, minahedhës 62 milimetërsh dhe forca të shumta këmbësorie për t’i mposhtur njësitet e UÇK-së. Në radhët e armikut ka pasur humbje. Kurse në radhët tona afër Gllavicë së Vranocit ranë heroikisht tre luftëtarë të Brigadës 135 “Agim Zeneli”, si: Adrian Kelmendi nga Kusuriqi polic ushtarak, Muharrem Kelmendi nga Peja dhe një luftëtar nga Qallapeku. Janë

plagosur edhe katër luftëtarë të tjerë. Në këtë vijë fronti edhe gjatë ditës së sotme luftimet janë duke vazhduar me të njëjtin intensitet, por njësitet e Brigadës 135 “Agim Zeneli” të ndihmuar edhe nga njësitet e Brigadës 131 “Jusuf Gërvalla”, e të Brigadës 132 “Myrtë Zeneli” po qëndrojnë të pamposhtura në pozicionet e veta duke u shkaktuar dëme të mëdha armiqve. Deri më tani gjatë ditës së sotme janë vrarë 7 policë serbë. Luftimet e ashpra janë duke u zhvilluar edhe në vijën Pozhar-Lumbardhë, si dhe në brezin kufitar Kosovë-Shqipëri ku njësitet e UÇK-së po përparojnë dukshëm duke i shkaktuar dëme të mëdha armikut. Gjithnjë duke qenë në epërsi kundër forcave pushtuese serbe. Në orët e hershme të mëngjesit gjatë një përleshjeje me forcat policore ushtarake serbe në Rugovë të Gjakovës u vranë 22 veta, disa prej të cilëve ishin luftëtarë të UÇK-së, të Zonës Operative të Dukagjinit. Në përballje të rreptë me armikun ranë heroikisht këta luftëtarë: Agush Gjoci nga Rashiqi i Pejës, Agim Zeneli nga Jabllanica e Gjakovës, Sejdi Avdyl Rama nga Smolica e Gjakovës, Luan Avdi Smajli nga Jabllanica, Valon Gashi nga Zllakuqani i Pejës, Daut Idriz Kelmendi nga Banja e Istogut, Agron Osman Rama nga Smolica e Gjakovës, Naim Xhafer Gashi nga Sferka e Klinës, Lulzim Qazim Ademaj nga Smolica e Deqanit. Ndërsa sot rreth orës 12:00 në Jabllanicë të Gjakovës, u bë varrimi i dëshmorit Agron Osman Rama, i cili u vra ditë më parë në përleshje me forcat serbe në Rogovë të Gjakovës. Në varrim morën pjesë shumë ushtarakë nga Brigada 131, 132, 134 komandant i së cilës ishte Agron Rama. Varrimi i tij u përcoll nga Togu i Nderit të Brigadës 132 të Komandës së Zonës Operative të Dukagjinit. Fjalimin mortor e lexoi ushtarja Ajshe Mulaj”.

## **24 prill 1999**

“Prej datës 27 mars e deri më tani në ZOP të Dukagjinit u zhvilluan luftime të rrepta në mes të forcave të shumta ushtarako-policore serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke përfshirë rajonin e Komunës së Deqanit, Gjakovës, Pejës, Istogut e tërë Rugovës. Në të gjitha vijat e frontit luftëtarët e UÇK-së treguan vendosmëri, heroizëm e guxim të pashoq duke i shkaktuar humbje të mëdha forcave serbe si në njerëz ashtu edhe në teknikë luftarake. Prej datës 2 deri më 5 prill, për katër ditë me radhë, forcat serbe ndërmorën një ofensivë të ashpër kundër UÇK-së, në rajonin e Dushkajës, duke sulmuar fillimisht fshatin

Kralan ku ditë më parë ishin strehuar mbi 30 mijë të zhvendosur nga Klina, Skenderaj e komuna tjera gjë që e vështirësoi së tepërmi rezistencën e njësive të UÇK-së. Me gjithë këtë, njësitet tona u treguan të pathyeshme përballë forcave të shumëfishuara serbe në vijën frontale Kralan, Bokshiq, Çeskovë, Buqan, Jabllanicë, Zhebel, por edhe në anën ku operon Brigada 132 “Myrtë Zeneli” dhe Brigada 135 “Agim Zeneli”. Qëndresë e pathyeshme u bë edhe në vijën e frontit Ratishë, Lumbardhë, Pozhar, Kodrali e Llukë, ku operon Brigada 131 “Jusuf Gërvalla”. Në këto luftime ranë heroikisht: Elez Ramë Geci nga Lluka e Poshtme, ndihmëskomandant për moral pranë Brigadës 131 “Jusuf Gërvalla”; Maxhun Berisha nga Prapaqani, komandant Kompanie pranë Brigadës 131 “Jusuf Gërvalla”; Artan Mehmetaj nga Glllogjani, pjesëtar i Brigadës 131, një vullnetar nga Shqipëria pjesëtar i Brigadës 134 “Bedri Shala”; Visar Miftari nga Gjakova pjesëtar i Njesisë Speciale; Kujtim Qallaku nga Baballoqi pjesëtarë i Njesisë Speciale; Fehmi Shala nga Cërmjani, pjesëtarë i Brigadës 132; Shefqet Dervishaj nga Kralani, pjesëtar i Brigadës 132; Naser Ibrahimimi nga Jabllanica, pjesëtar i Brigadës 132; Zeqir Gashi nga Buqani, pjesëtar i Brigadës 135; Adem Delia nga Zhebeli, komandant pranë Brigadës 132. Më 16 prill 1999 në një betejë të rreptë që u zhvillua fyt për fyt, e dhëmb për dhëmb me forcat pushtuese serbe në Zhebel ranë heroikisht dëshmorët glllogjanas: Shkëlzen Hilmi Haradinaj zëvendëskomandant i ZO të Dukagjinit për operacione dhe njëri ndër luftëtarët më të hershëm të UÇK-së; luftëtarë e strategë të shkëlqyer, Fatmir Nimanaj, Arsim Halilaj, e Luan Nimanaj që të tre eprorë pranë Brigadës 131 “Jusuf Gërvalla”, duke lënë të vranë në fushëbetejë me dhjetëra policë serbë. Prej datës 9 prill 1999 njësitet e UÇK-së, thyen kufirin shqiptaro-shqiptar në rajonin e Rekës së Keqe dhe i sulmuan forcat ushtarako-serbe duke korrur suksese të vazhdueshme luftarake. Ata arritën ta vejnë nën kontroll Kosharën deri në afërsi të Junikut. Në këtë rajon ushtria dhe policia e armikut pati dhe ka dëme të mëdha në njerëz dhe në arsenal luftarak, njësitet tona po marshojnë përpara me hapa të sigurt. Në këtë rajon në këto luftime kanë rënë 9 pjesëtarë të UÇK-së. Në rajonin e Istogut ku operon Brigada 133 “Adrian Krasniqi” luftime më të rrepta u zhvilluan më 13 prill 1999 ku gjatë gjithë kohës kishte granatime të fuqishme. Në këto luftime të rrepta ranë dëshmorët: Ismet Mustafë Bicaj - Vrellë, Muharrem Smajl Vuthaj - Vrellë, Skënder Malush Maraj - Vrellë, Nezir Salih Maraj - Vrellë, Izet Rexhep Shatri -

Tomoc, Bujar Visoqi - Llukavc i Begut, Abedin Dërvishaj - Zabllaq, Xhafer Mehmetaj - Zabllaq, Sami Gashi - Prigodë, Smajl Fetahaj - Vrellë, Sylë Qeta - Trubuhoc, Qazim Hakaj - Orrobërd, Nexhmedin Hakaj - Orrobërd, Faruk Zekaj - Radavc, Elez Berisha - Ruhot, të gjithë pjesëtarë të Brigadës 133 “Adrian Krasniqi”. Ushtrisë dhe policisë serbe gjatë luftimeve në rajonin e Istogut iu shkaktuan dëme të konsiderueshme në teknikë lufte dhe në njerëz. Rreth 60 policë e ushtarë të vrarë. Aksionet e pushtuesve serbë në këto anë po vazhdojnë me sukses. Përmendim këtu aksionet e datës 22 prill 1999 në Vrellë në lagjen e Berishajve, ku njësi gueril ka vrarë të paktën 5 policë serbë dhe ka plagosur po aq të tjerë. Gjatë kësaj kohe trupat ushtarako-policore serbe në fshatrat Lubozhdë, Vrellë, Prigodë, Radavc e Jabllanicë të Istogut kanë vrarë e masakruar mbi 15 civilë shqiptarë. Në Rugovë të Pejës prej datës 15 e deri më 20 prill 1999 u zhvilluan luftime të rrepta. Fillimisht ushtria serbe tentoi të depërtojë në Rugovë kah Qafa e Hajlës, por nuk arritën dot falë qëndresës së UÇK-së. Këtu u plagos rënd Xhavit Salih Lajçi, i cili vdiq sapo u dërgua në spital. Edhe të nesërmen luftimet ishin të intensitetit të lartë, serbët tentuan të depërtojnë kah Pepajt, por fal vendosmërisë së UÇK-së ata u kthyen prapa. Në këto luftime afër Hajlës ranë heroikisht: Selman Bekë Lajçi, magjistër i shkencave agronomike, përgjegjës për Informim pranë Brigadës 136 “Rugova” dhe njëri ndër themeluesit e saj, i cili tërë jetën ia kushtoi organizimit dhe veprimtarisë ilegale. Ndërsa pas daljes së UÇK-së në skenë, iu bashkua radhëve të saj në nëntor të vitit 1997 dhe luftoi me armë në dorë deri në rënien heroike. Këtu ranë edhe Besnik Musë Lajçi, profesor i gjuhës shqipe, komandant i njësitit vëzhgues dhe njëri ndër themeluesit e Brigadës 136 “Rugova”, bashkë me Selman Lajçin, si dhe dëshmori Ramush Nik Lajçi, polic ushtarak. Forcat serbe pasi s’mundën të depërtojnë kah Pepajt ndërruan drejtin kah Guri i Ndrenikës për t’u bashkuar me forcat tjera serbe që vinin kah Klina dhe Gryka e Rugovës. Më 20 prill 1999 Ushtria Çlirimtare e Kosovës u detyra të tërhiqej nga pozicionet në Qafë të Qyqes e në Shtupeq të Madh, ku ranë dëshmorët: Asllan Salih Nikçi, Faton Zeqir Nikçi dhe Rifat Bekë Shala, ushtarë të Batalionit të Tretë të Brigadës 136 “Rugova”. Po këtë ditë ushtria serbe tenton të depërtojë kah Qafa e Dasmorëve, ku gjatë tërë ditës kishte granatime të fuqishme nga Qakorri, si pasojë e të cilave u plagosën një numër i madh i ushtarëve tanë. Forcat serbe në këto beteja patën humbje të mëdha në njerëz. Burimet nga Rozhaja bëjnë të

ditur se duke ikur për në Mal të Zi një numër i konsideruar burrash janë ndarë nga familjet të cilët janë arrestuar e më vonë janë pushkatuar. Në rrethinën e Gjakovës po vepron me sukses Brigada 137 “Gjakova” duke goditur vazhdimisht forcat armike. Me gjithë vështirësitë e shumta në këtë ofensivë me gjithë dhembjen e shumë ushtarëve të dalluar e në mesin e tyre edhe të disa komandantëve duke pasur në barrë edhe popullsinë civile dhe një numër të madh të të plagosurve, shumica e të cilëve të palëvizshëm, UÇK-ja në ZOD arriti të bëj evakuimin e të gjithë të plagosurve dhe t’i bëj ballë me sukses këtij tufani të egër sllav. Morali i ushtarëve është mjaft i lartë. Radhëve tona gjithnjë e më shumë po u bashkohen ushtarë të rijnë. Çdo ditë po kryhen aksione të suksesshme kundër ushtrisë e policisë serbe. Pas vrasjes së qindra policëve, ushtarëve e paramilitarëve serbë jehonë të veçantë pati vrasja e kryekriminelit serb Millutin Prashqeviq, shef i Sigurimit Serb për Gjakovë më 21 prill 1999, në Madanaj bashkë me 6 pjesëtarë të elitës së tij që udhëhoqën pothuajse të gjitha aksionet terroriste e ofensivat kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke kryer krimet më barbare kundër popullsisë civile shqiptare në rajonin e qytetit të Gjakovës, komunës së Deçanit e të Dushkajës”.

Fetenete Ramosaj zëdhënëse pranë Komandës së Zonës Operative të Dukagjinit